ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E DIGJITALIZIMIT DHE ADMINISTRATES PUBLIKE**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **202-26-9318-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **''Shqyrtimi i ashensorëve në ndërtesat qeveritare''**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**EALGA SH.P.K.**
NUI	**811862706**
Adresa	**Bulevardi Bill Klinton, BB 5/8 Hyrja D Nr.34**
Vendi	**Prishtinë,**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	**044 296 833**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Ajshe Shala**
Adresa elektronike	**ealga.ks@gmail.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**18.11.2026**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

''Shqyrtimi i ashensorëve në ndërtesat qeveritare''

Në bazë te tenderit te publikuar: Shqyrtimi i ashensorëve në ndërtesat qeveritare me NRP: 202-26-9318-2-2-1, ne afatin e rregullt kohor parashtrojmë kërkesë për rishqyrtim:

29.10.2026 – Njoftim për Kontrate

30.10.2026 – Kërkesa për Sqarime

10.11.2026 – Kërkesa për Rishqyrtim te Njoftimit per Kontrate

16.11.2026 – Pergjigjje në Kërkesën për Rishqyrtim

19.11.2026 – Ankesa në OSHP

30.11.2026 – Afati për dorëzimin e ofertave/kërkesës për pjesëmarrje

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

10.11.2026 – Kërkesa për Rishqyrtim te Njoftimit per Kontrate

16.11.2026 – Pergjigjje në Kërkesën për Rishqyrtim

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK me rastin e zbatimit te aktiviteti te prokurimit me titull: **Shqyrtimi i ashensorëve në ndërtesat qeveritare me NRP: 202-26-9318-2-2-1** nuk ka respektuar dispozitat Ligjit për Prokurim Publik nr. Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068, Nr. 05/L-092, dhe Udhëzuesin Operative dhe Rregulloret e Prokurimit si ne vijim:

Neni 59 të LPP-së

Neni 40 te RRPP 002/2024

Neni 69 të LPP-së

Neni 6 të LPP-së

Gjithasthu në dosjen e tenderit nuk është rrespektuar baza kryesore ligjore e inspektimit periodik të ashensorëve në Republikën e Kosovës, që është rregullorja e RKS/MTI-së Nr. 05/2018, e cila rregullon sigurinë e ashensorëve në përdorim.

Përmes kësaj ankese, EALGA Sh.p.k., në cilësinë e trupës inspektuese të licensuar nga RKS/MTI, paraqet ankesë në OSHP lidhur me dosjen e tenderit për aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur.

Kjo ankesë bazohet në nenin 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i plotësuar me ligjet Nr. 04/L-237, Nr. 05/L-068 dhe Nr. 05/L-092.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Sipas Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje ligjore:

Pretendimi 1:

Në Republikën e Kosovës, veprimtaria e inspektimit të ashensorëve është fushë e ndjeshme dhe e rregulluar me dispozita të veçanta ligjore dhe nënligjore, të nxjerra nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI). Në mënyrë të veçantë, inspektimi periodik i ashensorëve rregullohet me Rregulloren (RKS/MTI) Nr. 05/2018 për Sigurinë e Ashensorëve në Përdorim.

Neni 13
Trupi i emëruar për inspektimin e ashensorëve

1. Trupi i emëruar për inspektimin teknik të ashensorëve duhet të jetë i regjistruar në Republikën e Kosovës.

2. Trupi i emëruar duhet t'i plotësojë kërkesat për trupat e emëruara të përcaktuara në Ligjin Nr. 06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit dhe kërkesat e përcaktuara në Rregulloren për Sigurinë e Ashensorëve.

3. Për të marrë emërim të vlefshëm, trupi i emëruar duhet të punësojë me orar të plotë të paktën një inxhinier të diplomuar të inxhinierisë elektronike dhe të paktën një inxhinier të diplomuar të inxhinierisë mekanike që i plotësojnë kërkesat e zbatueshme për stafin profesional që kryejnë inspektimin e ashensorëve siç përcaktohet me këtë Rregullore.

Rregullorja RKS/MTI 05/2018 nuk parasheh profilet Automatikë dhe Mekatronikë të kërkuara nga AK!

Ndër tjera kjo rregullore përcakton edhe kapacitetin teknik të cilin duhet trupat inspektues ta plotësojnë. Konkretisht, Neni 13, pika 3 e Rregullores (RKS/MTI) Nr. 05/2018 përcakton shprehimisht se Trupi i Emëruar për inspektim duhet të ketë të punësuar të paktën një inxhinier të diplomuar të inxhinierisë mekanike dhe një të inxhinierisë elektronike. Rrjedhimisht, legjislacioni në fuqi i përcakton në mënyrë të qartë dhe shteruese profilet profesionale që duhet ti ketë stafi i një trupi inspektues për inspektimin e ashensorëve.

Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktues nuk mund të vendosë kërkesa shtesë për profile të tjera inxhinierike, të cilat ligjërisht janë plotësisht të panevojshme për realizimin e kontratës në fjalë. Rregullorja RKS/MTI 05/2018 përcakton profilet inxhinierike pikërisht

për të mos lënë hapësirë për manipulime dhe fontana dëshirash për krijimin e barrierave artificiale nga pronarët e ashensorëve ose Autoritetet Kontraktuese me qëllim favorizimin e një trupi inspektues të caktuar.

3.4. Të dhënat për kompetencën teknike të punonjësve dhe të personave të tjerë të angazhuar në aktivitetet e vlerësimit të konformitetit, (në tekstin e mëtejmë: Personeli),

3.4.1. Për të marrë emërim të vlefshëm, trupi i emëruar duhet të punësojë me orar të plotë të paktën një inxhinier të diplomuar të inxhinierise elektronike dhe të paktën një inxhinier të diplomuar të inxhinierisë mekanike, neni 13 paragrafi 3 i Rregullores

Për më tepër, më datë 17.09.2026, MINTI ka publikuar ftesën publike për emërimin e trupave inspektues për inspektimin e ashensorëve. Edhe në këtë thirrje publike, Ministria ka specifikuar qartë në pikën 3.4.1 se trupi inspektues duhet të ketë në përbërjen e stafit një inxhinier të makinerisë dhe një inxhinier të elektronikës. Në këtë thirrje nuk parashihet si kërkesë angazhimi i inxhinierëve të profileve të Automatikë apo Mekatronikës, e as posedimi i ndonjë licence shtesë nga Ministria e Punës.

Nëse profilet e tilla (Automatikë, Mekatronikë, Licensë e Ministrisë së Punës) do të konsideroheshin që kanë të bëjnë sadopak me ushtrimin e veprimtarisë së inspektimit të ashensorëve, ato do të ishin kërkuar në thirrjen publike të MINTI. Po ashtu, MINTI nuk do të emëronte trupa inspektues që nuk i plotësojnë këto kërkesa shtesë, siç pretendohet nga Autoriteti Kontraktues. Fakti që ne kemi arritur të vazhdojmë emërimin nga MINTI për inspektimin e ashensorëve para pak kohësh, pa pasur në stafin inxhinierë të Automatikës dhe Mekatronikës, dëshmon qartë se këto kërkesa nuk janë parakusht ligjor për ushtrimin e kësaj veprimtarie dhe realizimin e kësaj kontrate. Këto kushte të vendosura nga Autoriteti Kontraktues janë vetëm barriera artificiale për kurdisje të tenderit dhe favorizim të një trupe inspektuese të caktuar.

Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues (AK), në Dosjen e Tenderit (DT) te pika 9.1 dhe 9.2, ka vendosur kritere që tejkalojnë kërkesat e rregullativës së veçantë që rregullon këtë fushë në Republikën e Kosovës. Konkretisht, Neni 13, pika 3 e Rregullores (RKS/MTI) Nr. 05/2018 përcakton shprehimisht se Trupi i Emëruar për inspektim duhet të ketë të punësuar të paktën një inxhinier të diplomuar të inxhinierisë elektronike dhe një të inxhinierisë mekanike.

Duke kërkuar inxhinierë të profileve “Mekatronikë” apo “Automatikë”, AK-ja ka dalë jashtë kornizës ligjore, ka krijuar diskriminim dhe ka ngushtuar pa të drejtë konkurrencën në treg, duke favorizuar operatorë të caktuar (potencialisht kurdisje e tenderit).

Me këtë rast nga AK është bërë shkelja e nenit 7 (Parimet e Përgjithshme) dhe nenit 69 (Kapaciteti Teknik dhe/ose Profesional) të LPP-së, në ndërlidhje me Rregulloren (RKS/MTI) Nr. 05/2018 për Sigurinë e Ashensorëve në Përdorim. Stafi i kërkuar nga AK është plotësisht i panevojshëm për realizimin e kontratës në fjalë. Pa këtë staf fare ne e kemi vazhduar para një muaji emërimin për inspektim të ashensorëve në MINTI, nëse kish qenë ky staf relevant, neve nuk na u kishte vazhdu emërimi. Ky staf nga AK po kërkohet vetëm për kurdisje të tenderit ndaj një operatori të caktuar.

Andaj përmes kësaj kërkese kërkojmë nga AK që të ndryshojë dosjen e Tenderit tek Pikat

9.1 dhe 9.2 pra pjesa "Kërkesat mbi
mundësitë teknike dhe/ose profesionale" më saktësisht pika 1 dhe nënpikat a,b,c të këtij sektori si në vijim:

1.Operatori ekonomik ose grup i OE pjesëmarrës duhet të ofroj dëshmi se ka staf të mjaftueshëm, të kualifikuar dhe të verifikuar nga DAK dhe MINTI për realizimin e kontratës së paku:

a) Një (1) Menaxher të kontratës Inxhinier i Inxhinierisë Mekanike me së paku pesë (5) vite përvojë në menaxhimin e inspektimeve të ashensorëve.


b) Një (1) Inxhinier i Inxhinierisë Elektronike me së paku tre (3) vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit) në fushën e ekzaminimeve dhe testimit të ashensorëve.

Shënim: Për informimin tuaj vetëm inxhinierët e deklaruar dhe të verifikuar gjatë procesit të akreditimit në MINTI/DAK dhe emërimit (MINTI) gëzojnë të drejtën e qasjes në ashensorë për inspektim kurse të tjerët jo.

Sqarim: Ky pretendim është vlerësuar si pjesërisht i bazuar nga AK në përgjigjjen e kërkesës tonë për rishqyrtim. Lidhur me mospajtimin tonë me ndryshimet që AK i ka bërë në Dosjen e Tenderit kinse për ta harmonizuar këtë pretendim, ne kemi formuluar Pretendimet 4, 5, 6 dhe 8.

Pretendimi 2:

Autoriteti Kontraktues ka kërkuar licensë nga Ministria e Punës lidhur me sigurinë dhe shëndetin në punë, kriter ky që nuk ndërlidhet fare me specifikat e shërbimit që kërkohet. Ky aktivitet prokurimi ka për objekt "Shqyrtimin e ashensorëve në ndërtesat qeveritare", që nënkupton inspektimin teknik në objekte ekzistuese dhe të përfunduara dhe me destinim të pastër zyrash. Certifikimi apo licenca e kërkuar nga Ministria e Punës nuk ka të bëjë fare me ashensorët, as trajnimi, as kurrikula, e as provimi. Kërkesat dhe licencat e sigurisë në punë specifike që ka kërkuar AK-ja hyjnë në shprehje dhe janë të aplikueshme për kantiere ndërtimi (punë ndërtimore) dhe jo për shërbime të pastra inspektimi teknik të ashensorëve në përdorim.



Edhe në rastet kur inspektohen ashensorët në objekte me rrezikshmëri të lartë (siç janë fabrikat apo industritë e rënda), kompanive u kërkohet certifikimi ISO 45001:2018. Ndërtesat qeveritare janë objekte me zyra dhe nuk kanë asnjë specifikë apo rrezikshmëri të kësaj natyre.

Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues (AK), në Dosjen e Tenderit (DT) te pika 9.1 dhe 9.2, ka bërë vendosjen e kritereve të paarsyeshme, joproporcionale dhe jorelevante për natyrën e kontratës. Më saktësisht pjesa ku kërkohet që "inxhinieri të jetë i licencuar ose certifikuar për siguri dhe shëndet në punë nga ministria përkatëse". Kjo licensë nuk ka të

bëjë aspak me ashensorët. Askund në asnjë aktivitet të këtij licensimi nuk ndërlidhet me inspektimin e ashensorëve në përdorim në objekte të përfunduara. Dhe kjo licensë nuk parashihet me asnjë dispozitë ligjore të inspektimit të ashensorëve në përdorim.

Kjo kërkesë është plotësisht e panevojshme dhe vjen në kundërshtim të hapur me Parimin e Proporcionalitetit (Neni 7 i LPP-së) dhe nenin 69 të LPP-së. Ajo shërben vetëm si një barrierë artificiale dhe vegël për kurdisje të tenderit, me qëllim eliminimin e konkurrencës së lirë dhe favorizimin e operatorëve të caktuar ekonomikë. Rregullorja (RKS/MTI) Nr. 05/2018 nuk parashikon asnjë kërkesë të tillë për Trupave për Vlerësim të Konformitetit (TVK).

Andaj, ne kërkojmë nga AK që të hiqet plotësisht nga Dosja e Tenderit çfarëdo kërkese apo kriteri që ndërlidhet me licencat ose certifikimet për Siguri dhe Shëndet në Punë nga Ministria e Punës, duke qenë se ky shërbim ekzekutohet në objekte të përfunduara dhe Rregullorja (RKS/MTI) Nr. 05/2018 nuk parashihet një gjë të tillë.

Sqarim: Në përgjigjjen e kërkesës tonë për rishqyrtim. Ky pretendim është konsideruar pjesërisht i bazuar nga AK duke e larguar kriterin e licencës nga Ministria e Punës. Lidhur me kërkesën e re të AK kemi formuluar me Pretendimin 7.

Pretendimi3:

Ndryshimi i kritereve kualifikuese në këtë aktivitet prokurimi nuk bazohet në asnjë nevojë reale apo ndryshim ligjor, por është bërë në mënyrë tendencioze. Për më tepër ndryshimi arbitrar i kritereve të tenderit në krahasim me praktikat e kaluara, ngall dyshim se është bërë me qëllim eliminimin e qëllimshëm të konkurrencës dhe favorizimin e operatorëve të caktuar (kurdisje e pastër e tenderit).

Kompania jonë, si një Trupë Inspektuese e Akredituar dhe e Emëruar zyrtarisht nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINTI), i ka inspektuar ashensorët e ndërtesave qeveritare. Pikërisht këta ashensorë që janë objekt i këtij tenderi janë inspektaur nga ne disa herë gjatë dhjetë viteve të fundit. Në asnjërin prej këtyre tenderëve në 10 vitet e kaluara, këto kritere përjashtuese (si inxhinierët e mekatronikës/automatikës apo licencat e kantiereve nga Ministria e Punës) nuk kanë qenë asnjëherë pjesë e Dosjes së Tenderit.

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional** **1. Kompania të jetë e autorizuar sipas trupave inspektuese të rregullores RKS-09 2012 për ashensorët, neni 43.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **1. Licencë valide - për certifikim të rregullt të ashensorëve në përdorim nga organet kompetente te Republikës se Kosovës.**
		2. Kompania të plotësojë standardin SK EN ISO IEC 17020 – që e autorizon për kontrollimet e Ashensorëve ne Republikën e Kosovës	**2. Certifikata ISO IEC 17020 – që e autorizon për kontrollimet e Ashensorëve. Ne Republikën e Kosovës**
		3. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës ose grupi i operatorëve ekonomik, duhet të kenë të realizuara kontrata për shërbime të ngjashme -të përfunduara me sukses (nga njoftimi për kontratë për periudhën e shkuar tre vjeçare)	**3. Lista e kontratave e nënshkruar dhe vulosur e projekteve të ngjajshme në vlere 30,000.0 Euro me të cilën saktësohen shërbimet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin e shërbimit. Listës duhet ti bashkëngjiten dëshmi kopjen e certifikatës (certifikatave) ose referencës, të nënshkruara nga pranuesi i shërbimeve për kontratat dhe projektet e cekura në listë, me numër të prokurimit apo numër të kontratës dhe datën e tyre (kopje).**
		Tenderi i njejtë, inspektimi në vitin e kaluar 2025.!	

Është paradoksale dhe haptazi e paligjshme që një trupe inspektuese, e cila i posedon të gjitha licencat dhe emërimet shtetërore për ashensorë në përdorim, ti pamundësohet aplikimi përmes kushteve artificiale. Kjo ndodh duke përdorur këto kritere të reja si instrument specifik për eliminimin tonë dhe kurdisjen e tenderit për operatorë të caktuar.

Kjo praktikë bie në kundërshtim të plotë me Nenin 7 (Parimi i Barazisë në Trajtim dhe Mosdiskriminimit) dhe Nenin 6 (Eficienca) të LPP-së. Autoriteti Kontraktues ka përdorur autoritetin e tij diskrecionar jo për të siguruar shërbimin më të mirë, por për të ndërtuar një dosje tenderi të përshtatur ekskluzivisht për kritere që plotësohen vetëm nga operatorët e favorizuar, duke dëmtuar buxhetin e shtetit dhe duke eliminuar operatorin që e ka kryer këtë shërbim me sukses për një dekadë.

Andaj kërkojmë që për të pasur garë të barabartë dhe qasje në tender për të gjitha trupat inspektuese, kriteret teknike të tenderit të harmonizohen me legjislaturën në fuçi dhe parktikat e kaluara të po këtij tenderi. Në këtë mënyrë AK kërkon që trupa inspektuese të jetë e akreditуar me ISO:17020 nga DAK edhe e emëruar nga MINTI. Duke i lënë kërkesat për kapacitetet profesionale dhe teknike të përfshiera në akreditimin dhe emërimin shtëror për inspektim të ashensorëve.

Sqarim: Në përgjigjjen e kërkesës tonë për rishqyrtim, AK e ka injoruar komplet këtë Pretendim ankimor tonin sikur të mos egzistonte fare. Siq mund ta shini në përgjigjjen e AK ndaj kërkesës tonë për rishqyrtim, AK është përgjigjur vetëm për Pretendimet 1 dhe 2. Pretendimin 3 e ka injoruar në tërësi në kundërshtim me LPP. Tek Pretendimi 6 kemi

elaboruar mëtutje arsyjet pse Pretendimi 3 duhet shpallur i bazuar.

Pretendimi 4:

Fillimisht, theksojmë se ky pretendim nuk ka qenë pjesë e kërkesës sonë fillestare për rishqyrtim. Megjithatë, paraqitja e tij në këtë fazë është rrjedhojë e drejtpërdrejtë e rrethanave të reja të krijuara pas përgjigjes së Autoritetit Kontraktues (AK) ndaj kërkesës sonë për rishqyrtim, si dhe ndryshimeve të bëra nga AK në Dosjen e Tenderit. Rrjedhimisht, ky pretendim lidhet me përmbajtjen aktuale të Dosjes së Tenderit dhe me kushtet e vendosura nga AK pas shqyrtimit të kërkesës sonë.

Inspektimi periodik i ashensorëve në Republikën e Kosovës rregullohet me Rregulloren RKS/MTI 05/2018 për Sigurinë e Ashensorëve në Përdorim. Sipas kësaj rregulloreje, inspektimi periodik i ashensorëve mund të kryhet vetëm nga trupat inspektuese të emëruara nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI), në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara me këtë akt nënligjor.



Në këtë drejtim, neni 13 i Rregullores RKS/MTI 05/2018 përcakton në mënyrë të qartë përbërjen profesionale të stafit që duhet të ketë një trup inspektues. Konkretisht, kërkohet që në përbërje të stafit të jenë dy inxhinierë të diplomuar:

• Një inxhinier të Inxhinierisë Elektronike, ku përcaktohet specifikisht drjetimi i studimit (Elektronikë) brenda Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike
• Një inxhinier të Inxhinierisë Mekanike, pa përcaktuar ndonjë drejtim të veçantë të studimeve brenda këtij fakulteti.

Pra, rregullorja përcakton dy profile konkrete inxhinierike, të cilat janë të domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë së inspektimit periodik të ashensorëve.

Vlen të theksohet se rregullorja nuk përcakton nivelin specifik të studimeve Bachelor apo Master, por përdor terminologjinë inxhinierë të diplomuar. Po ashtu, rregullorja nuk përcakton se cili nga këta dy inxhinierë duhet të caktohet si menaxher i projektit apo kontratës. Për këtë arsye, konsiderojmë se cilido nga dy inxhinierët e kërkuar mund të caktohet nga Operatori Ekonomik si menaxher i kontratës.

Duke pasur parasysh këtë përcaktim të qartë rregullativ, AK nuk ka të drejtë të ndryshojë kërkesat për profilet profesionale të përcaktuara me rregullore, duke shtuar pozita apo duke lejuar zëvendësime që nuk kanë mbështetje në aktin përkatës nënligjor.

Për rrjedhojë, kërkesa mbi kapacitet teknike dhe profesionale AK-së në pikën 9.1 dhe 9.2 të Dosjes së Tenderit, për angazhimin e tre (3) inxhinierëve, është në kundërshtim me kërkesat e nenit 13 të Rregullores RKS/MTI 05/2018. Një kërkesë e tillë tejkalon numrin e inxhinierëve të përcaktuar me rregullore dhe krijon kritere shtesë, të cilat nuk rezultojnë të domosdoshme për realizimin e aktivitetit objekt i këtij tenderi.

Konsiderojmë se AK duhet të kërkojë vetëm dy (2) inxhinierët e përcaktuar shprehimisht në Rregulloren RKS/MTI 05/2018, përkatësisht një inxhinier të Inxhinierisë Elektronike dhe një inxhinier të Inxhinierisë Mekanike.

Sa i përket inxhinierit të Inxhinierisë Elektronike, Rregullorja RKS/MTI 05/2018 është e qartë në përcaktimin e profilit profesional që kërkohet. Kërkohet inxhinier i drejtimit Elektronikë, në kuadër të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike.

1.Operatori ekonomik ose grup i OE pjesëmarrës duhet të ofroj dëshmi se ka staf të mjaftueshëm, të kualifikuar dhe të licencuar (me licencimin nga Oda përkatëse) për realizimin e kontratës së paku :

a) (1) Menaxher të kontratës një inxhinier të diplomuar ose Master të Inxhinierisë Mekanike me program studimi në Mekatronikë, ose së paku një inxhinier të diplomuar ose Master të Inxhinierisë Elektrike me program studimi në Elektronikë.

Rregullorja RKS/MTI 05/2018 nuk parasheh që Inxhinieri i Inxhinierisë Mekanike të jetë i drejtimit Mekatronikë siq ka kërkuar AK.

Kjo Rregullore nuk parasheh që Inxhinieri i Inxhinierisë Elektronike të jetë i zëvendësueshëm siq ka Lejuar AK.

Neni 13
Trupi i emëruar për inspektimin e ashensorëve

1. Trupi i emëruar për inspektimin teknik të ashensorëve duhet të jetë i regjistruar në Republikën e Kosovës.

2. Trupi i emëruar duhet t'i plotësojë kërkesat për trupat e emëruara të përcaktuara në Ligjin Nr. 06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit dhe kërkesat e përcaktuara në Rregulloren për Sigurinë e Ashensorëve.

3. Për të marrë emërim të vlefshëm, trupi i emëruar duhet të punësojë me orar të plotë të paktën një inxhinier të diplomuar të inxhinierisë elektronike dhe të paktën një inxhinier të diplomuar të inxhinierisë mekanike që i plotësojnë kërkesat e zbatueshme për stafin profesional që kryejnë inspektimin e ashensorëve siç përcaktohet me këtë Rregullore.

Rregullorja nuk parasheh asnjë dispozitë që lejon zëvendësimin e inxhinierit të Elektronikës me profile të tjera inxhinierike. Për rrjedhojë, çdo interpretim apo zgjerim i tillë nga ana e AK-së është pa bazë në Rregulloren RKS/MTI 05/2018. Inxhinieri i Elektronikës me asnjë dispozitë nuk mund të zëvendësohet profile të tjera të Inxhinierisë Elektrike, si Automatika, Elektroenergjetika etj. Aq më pak nuk mund të zëvendësohet me inxhinierë të Mekatronikës, të cilët i përkasin një fakulteti komplet tjetër, pra Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike.

Në këtë kontekst, kërkesa mbi kapacitet teknike dhe profesionale e AK-së në pikën 9.1 dhe 9.2 nënpika 1a, përmes së cilës lejohet që inxhinieri i Inxhinierisë Elektronike të zëvendësohet me inxhinierë të inxhinierise Mekanike të drejtimit të Mekatronikës, është në kundërshtim me rregulloren në fjalë. Një mundësi e tillë zëvendësimi nuk parashihet në asnjë dispozitë të saj.

Interpretimi ynë mbështetet edhe nga praktika konkrete e MINTI-t, si institucioni kompetent për emërimin e trupave inspektuese për inspektimin periodik të ashensorëve. Siç dëshmohet nga ftesa publike e MINTI-t, e publikuar në muajin shtator të këtij viti, për emërimin e trupave inspektuese për inspektimin periodik të ashensorëve, është kërkuar shprehimisht që stafi profesional i trupit inspektues të përfshijë inxhinier të Elektronikës.

3.4. Të dhënat për kompetencën teknike të punonjësve dhe të personave të tjerë të angazhuar në aktivitetet e vlerësimit të konformitetit, (në tekstin e mëtejmë: Personeli),

3.4.1. Për të marrë emërim të vlefshëm, trupi i emëruar duhet të punësojë me orar të plotë të paktën një inxhinier të diplomuar të inxhinierise elektronike dhe të paktën një inxhinier të diplomuar të inxhinierisë mekanike, neni 13 paragrafi 3 i Rregullores

Madje, disa kompanive u është refuzuar emërimi në këtë ftesë publike për këtë veprimtari për shkak se kanë aplikuar me inxhinierë të Inxhinierisë Elektrike, por të profileve të tjera, si Elektroteknikë, Elektroenergjetikë etj., dhe jo me inxhinierë të drejtimit Elektronikë. Kjo dëshmon se edhe vetë institucioni kompetent, i cili zbaton Rregulloren RKS/MTI 05/2018 dhe emëron trupat inspektuese, e trajton profilin e inxhinierit të Elektronikës si kërkesë të veçantë dhe të pazëvendësueshme me profile të tjera.

Inxhinieri i Inxhinierisë Elektronike është shah në vete për inspektimin periodik të ashensorëve. Ai është i pazëvendësueshëm nga drejtimet ose profilet e tjera. Inxhinieri i Inxhinierisë Elektronike duhet kërkuar si i vetëm, pa "ose", dhe pa zëvendësime të mundshme. Pa inxhinier të elektronikës nuk lejohet inspektimi periodik i ashensorëve, as emërimi nga MINTI për këtë çështje. Kështu thotë Rregullorja RKS/MTI 05/2018 dhe të gjitha palët janë të detyruara ta respektojnë këtë dispozitë. Duke respektuar këtë dispozitë nuk duhet lejuar që Operatori Ekonomik të kualifikohet për këtë tender pa Inxhinier të Elektronikës.

Prandaj, kërkojmë që PA të kërkojë nga AK të përcaktojë shprehimisht kërkesën për një (1) inxhinier të Inxhinierisë Elektronike, pa lejuar zëvendësimin e tij me inxhinierë të profileve të tjera të Inxhinierisë Elektrike apo të fakulteteve të tjera. Saktësisht ashtu siq e parasheh rregullorja MTI/RKS 05/2018.

Sa i përket inxhinierit të Inxhinierisë Mekanike, neni 13 i Rregullores RKS/MTI 05/2018 përcakton kërkesën për një inxhinier të fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, pa specifikuar drejtimin e veçantë brenda tij.

Ne konsiderojmë se, nga aspekti profesional dhe teknik, për veprimtarinë e inspektimit të ashensorëve do të ishte më e përshtatshme të kërkohej një inxhinier i drejtimit Dizajn Inxhinierik, i njohur më herët si Konstruksione dhe Mekanizim. Këtë qëndrim e kemi shprehur edhe pranë MINTI-t.

Megjithatë, duke qenë se Rregullorja RKS/MTI 05/2018 nuk e përcakton një drejtim të tillë specifik, ne pajtohemi që në këtë tender të kërkohet inxhinier i diplomuar i Inxhinierisë Mekanike, pa kufizim të drejtimit brenda këtij fakulteti.

Mirëpo, ajo që nuk mund të pranohet është zëvendësimi i këtij inxhinieri me inxhinierë të fakulteteve të tjera si p.sh. inxhinierë të elektrikës, siç ka tentuar të bëjë AK përmes kërkesës mbi kapacitet teknike dhe profesionale e AK-së në pikën 9.1 dhe 9.2 nënpika 1b dhe 1c. Rregullorja RKS/MTI 05/2018 nuk parasheh asnjë mundësi që inxhinieri i Inxhinierisë Mekanike të zëvendësohet me inxhinier të Inxhinierisë Elektrike apo me ndonjë profil tjetër që nuk i përket Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike.

Inxhinieri i Inxhinierisë Mekanike është shah në vete për inspektimin periodik të ashensorëve. Ai është i pazëvendësueshëm nga drejtimet ose profilet e tjera. Inxhinieri i Inxhinierisë Mekanike duhet kërkuar si i vetëm, pa "ose", dhe pa zëvendësime të mundshme. Pa inxhinier të Inxhinierisë Mekanike nuk lejohet inspektimi periodik i ashensorëve, as emërimi nga MINTI për këtë çështje. Kështu thotë Rregullorja RKS/MTI 05/2018 dhe të gjitha palët janë të detyruara ta respektojnë këtë dispozitë. Duke respektuar këtë dispozitë nuk duhet krijuar kushtet Teorike që Operatori Ekonomik të kualifikohet për këtë tender pa Inxhinier të Inxhinierisë Mekanike.


Për rrjedhojë, kërkesa mbi kapacitet teknike dhe profesionale e AK-së në pikën 9.1 dhe 9.2 nënpika 1b dhe 1c, përmes së cilës lejohet zëvendësimi i inxhinierit të Inxhinierisë Mekanike me inxhinier të Inxhinierisë Elektrike, është në kundërshtim me nenin 13 të Rregullores RKS/MTI 05/2018. Një formulim i tillë krijon mundësinë që aktiviteti i inspektimit periodik të ashensorëve të realizohet pa praninë e një inxhinieri të Inxhinierisë Mekanike, ndonëse ky profil kërkohet shprehimisht nga rregullorja.

Prandaj, konsiderojmë se edhe inxhinieri i Inxhinierisë Mekanike duhet të kërkohet si profil i veçantë dhe i pazëvendësueshëm, duke lejuar vetëm fleksibilitetin lidhur me drejtimin brenda Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, ashtu siç e lejon vetë rregullorja.

Lidhur me përvojën e punës, neni 15 i Rregullores RKS/MTI 05/2018 përcakton kushtet e përvojës profesionale që duhet ti plotësojnë dy inxhinierët e përcaktuar në nenin 13, përkatësisht inxhinieri i Elektronikës dhe inxhinieri i Inxhinierisë Mekanike.

Ne pajtohemi plotësisht që të dy inxhinierët duhet të kenë përvojën përkatëse të punës, përkatësisht një (1) dhe tri (3) vite, sipas përcaktimeve të nenit 15 të kësaj rregulloreje.

Neni 15 përdor një formulim të përbashkët për përcaktimin e përvojës së punës së dy inxhinierëve të kërkuar sipas nenit 13, duke iu referuar sëbashku fushave përkatëse të Inxhinierisë Elektrike dhe Inxhinierisë Mekanike.



Duhet të theksohet se çdo inxhinier i Elektronikës (Drejtimi) është njëkohësisht inxhinier i Inxhinierisë Elektrike (Fakulteti), por jo dhe anasjelltas. Kjo referencë e inxhinierit përbashkët nuk nënkupton se çdo profil brenda këtyre fakulteteve mund të konsiderohet zëvendësues i profileve specifike të kërkuara në nenin 13.

Prandaj, referenca e nenit 15 në Inxhinierinë Elektrike nuk mund të interpretohet si mundësi për zëvendësimin e inxhinierit të Elektronikës me inxhinierë të profileve të tjera, si Automatika, Elektroenergjetika apo profile të ngjashme. Aq më pak nuk mund të përdoret kjo dispozitë për të lejuar zëvendësimin me inxhinierë të Mekatronikës, të cilët i përkasin një Fakulteti komplet tjetër pra Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike.

E njëjta logjikë vlen edhe për inxhinierin e Inxhinierisë Mekanike. Referenca në këtë fakultet nuk krijon mundësi që ai të zëvendësohet me inxhinierë të fakulteteve të tjera. Mënyra se si AK e ka interpretuar këtë dispozitë është e pasaktë dhe bie ndesh me përmbajtjen dhe qëllimin e saj.

Në këtë kontekst, kërkesa mbi kapacitet teknike dhe profesionale e AK-së në pikën 9.1 dhe 9.2 nënpika 1a, 1b dhe 1c, përmes së cilës lejohen alternativa të profileve të inxhinierëve është në kundërshtim me Rregulloren RKS/MTI 05/2018. AK nuk mund të shtojë, përmes interpretimit të vet, mundësi zëvendësimi të cilat nuk janë paraparë nga akti nënligjor përkatës.

Kërkojmë që AK të përcaktojë qartë se të dy inxhinierët, ai i Elektronikës dhe ai i Inxhinierisë Mekanike, duhet t'i plotësojnë kushtet e përvojës së punës sipas nenit 15 të Rregullores RKS/MTI 05/2018, pa lejuar zëvendësimin e profileve të kërkuara me profile të tjera.


Duke i përmbledhur të gjitha sa u theksuan më lart (Numri i Inxhinierëve, Inxhinieri i Elektronikës, Inxhinieri i Inxhinierisë Mekanike, Përvoja e Punës), ne kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së që këtë pretendim ankimor ta aprovojë si të bazuar dhe ta obligojë Autoritetin Kontraktues që të ndryshojë kërkesat mbi kapacitet teknike dhe profesionale përkatësisht pikën 9.1 dhe 9.2 nënpika 1 të Dosjes së Tenderit si në vijim:

1. Operatori ekonomik ose grup i OE pjesëmarrës duhet të ofroj dëshmi se ka staf të mjaftueshëm, të kualifikuar dhe të verifikuar nga DAK dhe MINTI për realizimin e kontratës konform legjislacionit në fuçi:
   a) Një (1) Inxhinier i Inxhinierisë Mekanike me përvojë pune sipas rregullores RKS/MTI 05/2018.
   b) Një (1) Inxhinier i Inxhinierisë Elektronike me përvoje pune sipas rregullores RKS/MTI 05/2018.
   c) Njëri nga Inxhinierët e mësipërm duhet të caktohet nga OE si Menaxher i Kontratës.

.

Pretendimi 5:

Fillimisht, theksojmë se ky pretendim nuk ka qenë pjesë e kërkesës sonë fillestare për rishqyrtim. Megjithatë, paraqitja e tij në këtë fazë është rrjedhojë e drejtpërdrejtë e rrethanave të reja të krijuara pas përgjigjes së Autoritetit Kontraktues (AK) ndaj kërkesës sonë për rishqyrtim, si dhe ndryshimeve të bëra nga AK në Dosjen e Tenderit. Rrjedhimisht, ky pretendim lidhet me përmbajtjen aktuale të Dosjes së Tenderit dhe me kushtet e vendosura nga AK pas shqyrtimit të kërkesës sonë.



Siç shihet në foton e mësipërme, AK, në kuadër të kërkesave për kapacitetin teknik dhe profesional, të përcaktuara në pikën 9.1 dhe 9.2 të Dosjes së Tenderit, në fund të nënpikës 1 ka shtuar një paragraf të ri, përmes të cilit përcakton profilet profesionale që mund të pranohen për përmbushjen e kërkesave lidhur me stafin profesional.

Në paragrafin e shtuar, AK fillimisht deklaron se ka "vendosur" që programet e studimit të mos merren parasysh gjatë vlerësimit të profileve profesionale të inxhinierëve. Konsiderojmë se një përcaktim i tillë është tërësisht i pabazuar në ligj dhe në kundërshtim me Rregulloren RKS/MTI 05/2018 për Sigurinë e Ashensorëve në Përdorim.

AK nuk ka kompetencë ligjore që, përmes një vendimi të njëanshëm apo një formulimi në Dosjen e Tenderit, të anashkalojë, ndryshojë apo relativizojë kërkesat e përcaktuara me një akt nënligjor që rregullon drejtpërdrejt veprimtarinë objekt i këtij tenderi. Kriteret e përcaktuara me Rregulloren RKS/MTI 05/2018 janë kërkesa detyruese, të cilave duhet t'u përmbahen të gjitha palët, përfshirë Autoritetin Kontraktues. AK nuk mund të vendosë në mënyrë arbitrare se cilat kërkesa të rregullores do t'i marrë parasysh dhe cilat do t'i shpërfillë.

Pasi deklaron se programet e studimit nuk do të merren parasysh, AK në të njëjtin

paragraf përcakton se ekipi profesional duhet të ketë së paku një inxhinier të Inxhinierisë Elektrike me program studimi Elektronikë, Automatikë, ose një inxhinier të Inxhinierisë Mekanike me program studimi Mekatronikë. Këtu shtrohet një pyetje thelbësore: Në bazë të cilës dispozitë të Rregullores RKS/MTI 05/2018 i ka përfshirë AK profilet Automatika dhe Mekatronika? Ato nuk përmenden fare në asnjë dispozitë të Rregullores.

Mënyra se si AK ka vepruar në këtë rast, veçanërisht përfshirja e profileve Automatika dhe Mekatronika në Dosjen e Tenderit, e ka thelluar edhe më tej dyshimin tonë të bazuar se kriteret e këtij aktiviteti të prokurimit mund të jenë përshtatur për ta favorizuar ndonjë operator ekonomik të caktuar dhe kemi të bëjmë me kurdisje të Tenderit.

Këto dyshime nuk janë ngritur vetëm në këtë fazë të procedurës. Siç e kemi theksuar edhe në kërkesën tonë për rishqyrtim, për shkak të rrethanave dhe parregullsive të konstatuara, jemi detyruar që rastin ta paraqesim edhe pranë Policisë së Kosovës, përkatësisht Departamentit për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit, si dhe me Kallëzim Penal pranë Prokurorisë Themelore në Prishtinë.

Gjatë dhënies së deklaratës në Policinë e Kosovës, ndër të tjera, jemi pyetur nga polici hetues se cilat kompani disponojnë inxhinierë të profileve Automatika dhe Mekatronika, të cilat AK i ka përfshirë sipas deklaratës tonë prej qielli në kriteret e tenderit. Në përgjigjen tonë kemi sqaruar se, nga pesë kompanitë e emëruara për inspektimin periodik të ashensorëve, sipas informatave që posedojmë, vetëm njëra prej tyre disponon profilet e tilla profesionale.

Ky fakt e bën edhe më shqetësues përfshirjen e këtyre profileve në Dosjen e Tenderit, pasi krijon dyshimin se kriteret nuk janë përcaktuar mbi bazën e nevojave objektive të kontratës dhe kërkesave të legjislacionit në fuqi, por mund të jenë formuluar në mënyrë të tillë që ti përshtaten kapaciteteve të një operatori të caktuar për qëllime korruptive.

Theksojmë se këto rrethana i paraqesim si fakte dhe informacione që mbështesin dyshimin tonë për trajtim favorizues, ndërsa vlerësimi përfundimtar i ekzistimit të ndonjë vepre penale u takon organeve kompetente të hetuesisë dhe ndjekjes. Shpresojmë që Policia e Kosovës dhe Prokuroria, përmes kompetencave dhe mekanizmave të tyre ligjorë, do ti shqyrtojnë këto rrethana dhe do ta trajtojnë rastin deri në zbardhjen e plotë të tij.

Duke u bazuar në të gjitha argumentet e paraqitura më lart, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së që këtë pretendim ankimor ta aprovojë si të bazuar dhe ta obligojë Autoritetin Kontraktues që të largojë plotësisht nga Dosja e Tenderit paragrafin e shtuar në fund të nënpikës 1, në kuadër të kërkesave për kapacitetin teknik dhe profesional në pikën 9.1 dhe 9.2.


Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues duhet të kufizohet në përcaktimin e kërkesave profesionale ashtu siç janë paraparë me Rregulloren RKS/MTI 05/2018, pa shtuar jashtëligjshëm alternativa, përjashtime apo mundësi zëvendësimi që nuk kanë bazë ligjore. Pasiqë subjekt i Tenderit është një veprimtari e rregulluar në mënyrë të detajuar me akte ligjore e nënligjore nga Ministria përkatëse.

Pretendimi 6:

Fillimisht, theksojmë se ky pretendim nuk ka qenë pjesë e kërkesës sonë fillestare për rishqyrtim. Megjithatë, paraqitja e tij në këtë fazë është rrjedhojë e drejtpërdrejtë e rrethanave të reja të krijuara pas përgjigjes së Autoritetit Kontraktues (AK) ndaj kërkesës sonë për rishqyrtim, si dhe ndryshimeve të bëra nga AK në Dosjen e Tenderit. Rrjedhimisht, ky pretendim lidhet me përmbajtjen aktuale të Dosjes së Tenderit dhe me kushtet e vendosura nga AK pas shqyrtimit të kërkesës sonë.

Institucioni kompetent përgjegjës inspektimin e ashensorëve në përdorim, përfshirë zbatimin e Rregullores RKS/MTI Nr. 05/2018, si dhe për emërimin e trupave inspektuese për kryerjen e inspektimeve periodike të ashensorëve, është Departamenti i Industrisë në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI).

Duke qenë se kjo fushë është e rregulluar me akte specifike ligjore dhe nënligjore, ne i jemi drejtuar institucionit kompetent, MINTI-t, me pyetje konkrete lidhur me kapacitetet e nevojshme profesionale të trupave inspektuese për kryerjen e inspektimeve periodike të ashensorëve në Republikën e Kosovës.



Përgjigje në kërkesë RE: Kërkesë për interpretim zyrtar për kapacitetet profesionale të trupave inspektuese për ashensorë sipas Rregullores RKS/MTI Nr. 05/2018

Gurakuq Kastrati Nov 17, 2026, 3:51 PM (2 days ago)
to me, Artan, Valbone, Flora

I nderuar,

Në lidhje me kërkesën tuaj ju njoftojmë si në vijim:

Kriteret për emërim nuk mund të zëvendësohen/aplikohen si kritere në procedurat e tenderimit. Andaj, këto kritere vlerësohen gjatë procedurës për marrjen e emërimit për trupat inspektuese për fushën e inspektimit periodik të ashensorëve nga Komisioni Profesional sipas UA (QRK) 05/2025.

Është e mjaftueshme që **trupa inspektuese të jetë e emëruar nga MINTI**, sipas Rregullores Nr.05/2018 për Sigurinë e Ashensorëve në Përdorim dhe **emërimi të ketë afat vlefshmërie**. Për marrje të emërimit trupa inspektuese duhet të ketë stafin e kualifikuar, **inxhinier të diplomuar të inxhinierisë elektronike** dhe **inxhinier të diplomuar të inxhinierisë mekanike** që i plotësojnë kërkesat për stafin profesional për inspektimin e ashensorëve. Këto janë kërkesa për marrje të emërimit nga MINT.

- **Nuk mund të zëvendësohet kriteri i inxhinierisë elektronike me drejtime tjera si energjetikë, automatikë, mekatronikë apo të ngjashme.**
- **Tek inxhinieria mekanike Rregullorja nuk veçon ndonjë drejtim specifik.**

P.S. Dispozitat e nenit 15 të Rregullores Nr.05/2018 për Sigurinë e Ashensorëve kanë të bëjnë me stafin profesional i cili kryen inspektimin e ashensorëve në përdorim, në ndërlidhje me nenin 13 të të njëjtës Rregullore.

Me respekt,
Gurakuq Kastrati
Udhëheqës i Divizionit për Infrastrukturë të Cilësisë/Departamenti I Industrisë

Në foton më lartë e bashkëngjitur mund të shihet përgjigjja zyrtare e pranuar nga MINTI lidhur me kërkesën tonë. Kjo përgjigje zyrtare jo vetëm që sqaron çështjet e ngritura nga ana jonë, por njëkohësisht i përforcon pretendimet tona ankimore lidhur me paligjshmërinë e kërkesave të vendosura nga Autoriteti Kontraktues (AK), si në vijim:

1. Në përgjigjen e saj, MINTI konfirmon se për kryerjen e inspektimeve periodike të ashensorëve kërkohet që trupi inspektues të përbëhet nga dy (2) inxhinierë dhe jo tre (3) inxhinierë, siç është përcaktuar nga AK në dosjen e tenderit. Rrjedhimisht, kërkesa e AK-së për tre inxhinierë nuk mbështetet në interpretimin e institucionit kompetent për këtë fushë.

2. MINTI konfirmon se profili i Inxhinierisë Elektronike është i domosdoshëm për përbërjen profesionale të trupit inspektues dhe nuk mund të zëvendësohet me profile të tjera, si Energjetika, Automatika, Mekatronika, siç është pretenduar nga AK. Kjo dëshmon se përcaktimi i profileve profesionale nuk mund të bëhet në mënyrë arbitrare nga AK, por duhet të jetë në përputhje me kërkesat dhe interpretimin e institucionit kompetent.

3. Po ashtu, MINTI konfirmon se Inxhinieri i Inxhinierisë Mekanike është pjesë e domosdoshme e përbërjes së trupit inspektues. Megjithatë, për këtë profil nuk përcaktohet ndonjë drejtim apo specializim i veçantë brenda fushës së Inxhinierisë Mekanike. Për rrjedhojë, AK nuk ka bazë të vendosë kufizime shtesë (drejtimi i Mekatronikës) lidhur me drejtimin specifik të këtij profili, përtej kërkesave të përcaktuara nga institucioni kompetent e as ta zëvendësojë me Inxhinier të Elektrikës.

4. Një nga sqarimet më të rëndësishme të përgjigjes zyrtare të MINTI-t është se verifikimi i përbërjes dhe kapaciteteve profesionale të trupit inspektues bëhet në kuadër të procesit të emërimit nga vetë MINTI. Rrjedhimisht, sipas interpretimit të MINTI-t, AK nuk duhet të vendosë kërkesa të veçanta për inxhinierë dhe profile profesionale si kritere të pavarura kualifikuese në dosjen e tenderit, pasi këto çështje tashmë janë objekt i procesit të emërimit dhe verifikimit nga institucioni kompetent.

Në këtë kuptim, emërimi i vlefshëm nga MINTI për kryerjen e inspektimeve periodike të ashensorëve përbën kriterin e vetëm përkatës kualifikues për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit për këtë shërbim. Të gjitha kriteret tjera duhet të largohen sepse janë vendosur qëllimisht nga AK për kurdisje të Tenderit de favorizim të një OE.

Përgjigjja zyrtare e MINTI-t e bën edhe më të qartë trajtimin joprofesional, në kundërshtim me LPP-në dhe të pabazuar të kërkesës sonë për rishqyrtim nga ana e AK-së. Në mënyrë të veçantë, dëshirojmë të theksojmë se në Pretendimin nr. 3 të kërkesës sonë për rishqyrtim kemi argumentuar qartë se, në procedurat e mëparshme të prokurimit të zhvilluara nga i njëjti Autoritet Kontraktues, si dhe në procedurat e zhvilluara nga autoritete të tjera kontraktuese për shërbime të inspektimit të ashensorëve, kriteri i kërkuar në mënyrë të vazhdueshme ka qenë vetëm emërimi (i cili në të kaluarën njihej si autorizim) nga MINTI për kryerjen e inspektimeve të ashensorëve.

Në këto procedura nuk janë vendosur kritere shtesë dhe të veçanta lidhur me profilet apo numrin e inxhinierëve apo pajisjeve, pasi këto çështje janë trajtuar dhe verifikuar në kuadër të procesit të emërimit nga institucioni kompetent.

Megjithatë, AK e ka injoruar tërësisht Pretendimin nr. 3 të kërkesës sonë për rishqyrtim, pa dhënë asnjë përgjigje, arsyetim apo vlerësim lidhur me argumentet dhe faktet e paraqitura nga ana jonë. Siç dëshmohet edhe nga përgjigjja e AK-së ndaj kërkesës sonë për rishqyrtim, ky pretendim është lënë plotësisht pa trajtim, sikur të mos ishte paraqitur fare.

Një qasje e tillë përbën trajtim të paplotë të kërkesës për rishqyrtim dhe cenon detyrimin e AK-së për të shqyrtuar dhe adresuar në mënyrë të argumentuar të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik. Autoriteti Kontraktues nuk mund të shmanget nga trajtimi i një pretendimi ankimor vetëm duke e lënë atë pa përgjigje, veçanërisht kur pretendimi mbështetet në praktikën e mëparshme të prokurimit dhe në kompetencat ligjore të institucionit përgjegjës për këtë fushë.

Konsiderojmë se interpretimi zyrtar i MINTI-t, si institucion kompetent dhe përgjegjës për rregullimin e kësaj fushe, duhet të merret për bazë nga Autoriteti Kontraktues gjatë përcaktimit të kërkesave teknike dhe profesionale në procedurat e prokurimit që kanë për objekt inspektimin periodik të ashensorëve. Autoriteti Kontraktues nuk mund të krijojë, në mënyrë të njëanshme, kërkesa dhe kritere shtesë profesionale për një veprimtari e cila tashmë është e rregulluar me akte ligjore dhe nënligjore dhe për të cilën kompetencat e verifikimit, vlerësimit dhe emërimit u takojnë institucioneve përkatëse shtetërore.


Vendosja e kërkesave të tilla, pa bazë të qartë në legjislacionin përkatës dhe në kundërshtim me interpretimin e institucionit kompetent, rrezikon të krijojë kufizime të panevojshme dhe joproporcionale për operatorët ekonomikë, duke cenuar parimet themelore të transparencës, trajtimit të barabartë, konkurrencës dhe proporcionalitetit në prokurimin publik.

Për më tepër, mosadresimi i Pretendimit nr. 3 nga ana e AK-së gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim dëshmon se argumentet tona nuk janë trajtuar në mënyrë të plotë dhe të mirëfilltë.

Duke i përmbledhur të gjitha sa u theksuan më lart, ne kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së që këtë pretendim ankimor ta aprovojë si të bazuar dhe ta obligojë Autoritetin Kontraktues që të ndryshojë kërkesat mbi kapacitet teknike dhe profesionale përkatësisht pikën 9.1 dhe 9.2 me të gjitha nënpikat duke larguar kërkesat e stafit për inxhinerë. Në këtë mënyrë duke respektuar interpretimin e MINTI të kërkohet vetëm emërimi për inspektim periodik të ashensorëve nga MINTI. I cili i përfshin kërkesat e stafit si pjesë e procedurave të emërimit.

Pretendimi7:

Fillimisht, theksojmë se ky pretendim nuk ka qenë pjesë e kërkesës sonë fillestare për rishqyrtim. Megjithatë, paraqitja e tij në këtë fazë është rrjedhojë e drejtpërdrejtë e rrethanave të reja të krijuara pas përgjigjes së Autoritetit Kontraktues (AK) ndaj kërkesës sonë për rishqyrtim, si dhe ndryshimeve të bëra nga AK në Dosjen e Tenderit. Rrjedhimisht, ky pretendim lidhet me përmbajtjen aktuale të Dosjes së Tenderit dhe me kushtet e vendosura nga AK pas shqyrtimit të kërkesës sonë.



Në dosjen e përmirësuar të tenderit, siç shihet edhe në fotografinë e mësipërme, Autoriteti Kontraktues (AK) ka shtuar një paragraf të ri, përmes të cilit kërkon që kompanitë të dëshmojnë përmbushjen e obligimeve ligjore në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Fillimisht, gëzohemi që AK ka marrë parasysh argumentet e paraqitura në Pretendimin nr. 2 dhe është bindur se trupat inspektuese nuk kanë nevojë të kenë të punësuar ekspertë të sigurisë në punë me orar të plotë.

Megjithatë, në listimin e kushteve që duhet të përmbushë një Operator Ekonomik (OE), AK nuk ka qenë mjaftueshëm specifik lidhur me dokumentacionin që duhet të dorëzohet për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri. Në këtë pjesë është përmendur trajnimi për siguri dhe shëndet në punë, i cili duhet të dëshmohet përmes certifikatave përkatëse për secilin punëtor, si dhe vlerësimi i riskut në vendin e punës për kompaninë.

Mirëpo, mënyra se si është formuluar ky kriter, përmes përdorimit të kllapave dhe shprehjes "p.sh.", është joprofesionale dhe lë hapësirë të konsiderueshme për paqartësi, keqinterpretim dhe madje edhe manipulim pas dorëzimit të ofertave.

Për të shmangur këto paqartësi dhe për të garantuar trajtim të barabartë të të gjithë operatorëve ekonomikë, kërkojmë që AK të precizojë qartë dokumentet dhe kërkesat që duhet të përmbushen në kuadër të kriterit për siguri dhe shëndet në punë. Në mënyrë të veçantë, duhet të përcaktohet se cili trajnim specifik kërkohet për secilin inxhinier dhe, veçmas, të kërkohet dorëzimi i vlerësimit të riskut në vendin e punës për kompaninë.

Nga ana tjetër, konsiderojmë se përmbushja e të gjitha kërkesave në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë dëshmohet përmes certifikatës ISO 45001. Kjo certifikatë, si kritere për lëshimin e saj i ka përmbushjen e të gjitha obligimeve lokale dhe ndërkombëtare të shëndetit dhe sigurisë dhe shëndetit në punë përfshi trajnimet përkatëse për stafin dhe vlerësimin e riskut në vendin e punës.


Prandaj, kërkojmë që AK të qartësojë dhe të precizojë kërkesat e këtij kriteri, në mënyrë që të mos mbetet hapësirë për interpretime subjektive dhe që të gjithë operatorët ekonomikë të kenë qartësi të plotë lidhur me dokumentacionin që duhet të dorëzojnë.

Duke u bazuar në të gjitha argumentet e paraqitura më lart, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së që këtë pretendim ankimor ta aprovojë si të bazuar dhe ta obligojë Autoritetin Kontraktues që të largojë plotësisht nga Dosja e Tenderit paragrafin e shtuar për Siguri dhe Shëndet në Punë në fund të nënpikës 1, në kuadër të kërkesave për kapacitetin teknik dhe profesional në pikën 9.1 dhe 9.2. Kërkesa për Siguri dhe Shëndet në Punë të definohet si pikë e veqantë e kërkesave për kapacitetin teknik dhe profesional si vijon:

2. Operatori ekonomik ose grup i OE pjesëmarrës duhet të ofroj dëshmi se ka përmbushur kriteret për Siguri dhe Shëndet në Punë konform legjislacionit në fuçi:
a) Të posedojë certifikatën valide ISO 45001 për Siguri dhe Shëndet në Punë.
b) Në rast të mosposedimit të certifikatës ISO 45001 për Siguri dhe Shëndet në Punë, përmbushja e kritereve të dëshmohet përmes dokumenteve në vijim:
i) Certifikata së Trajnimit për Siguri dhe Shëndet në Punë për secilin Inxhinier.
ii) Dokumenti i Vlerësimit të Rrezikshmërisë në vendin e Punës i lëshuar nga personi ose kompania kompetente.

Pretendimi8:

Fillimisht, theksojmë se ky pretendim nuk ka qenë pjesë e kërkesës sonë fillestare për rishqyrtim. Megjithatë, paraqitja e tij në këtë fazë është rrjedhojë e drejtpërdrejtë e rrethanave të reja të krijuara pas përgjigjes së Autoritetit Kontraktues (AK) ndaj kërkesës sonë për rishqyrtim, si dhe ndryshimeve të bëra nga AK në Dosjen e Tenderit. Rrjedhimisht, ky pretendim lidhet me përmbajtjen aktuale të Dosjes së Tenderit dhe me kushtet e vendosura nga AK pas shqyrtimit të kërkesës sonë.



Siç shihet në fotografinë e mësipërme, në dosjen fillestare të tenderit, AK nuk e kishte kërkuar licencën A të lëshuar nga Oda e Inxhinierëve të Kosovës.

Megjithatë, në dosjen e përmirësuar të tenderit, AK e ka përfshirë këtë kriter në mënyrë të njëanshme dhe pa dhënë asnjë sqarim. Theksojmë se ky kriter nuk është përmendur fare nga ana jonë në ankesën e paraqitur. Për më tepër, AK nuk ka ofruar asnjë arsyetim dhe asnjë referencë ligjore se mbi çfarë baze ligjore është vendosur ky kriter i ri. Pra, ky ndryshim është bërë në heshtje.

Dëshirojmë të theksojmë se stafi ynë është anëtar i Odës së Inxhinierëve të Kosovës që nga dita e parë e themelimit të saj. Madje, njëri nga inxhinierët tanë është personi i parë në Kosovë të cilit kjo Odë i ka lëshuar licencën A, me numër rendor 001.

Megjithatë, me gjithë respektin për kolegët tanë të Odës së Inxhinierëve të Kosovës dhe punën e tyre të palodhshme, me kompetencë profesionale dhe përgjegjësi të plotë deklarojmë se licencat A dhe B të lëshuara nga Oda e Inxhinierëve të Kosovës nuk kanë asnjë ndërlidhje me fushën e inspektimit të ashensorëve.



ODA E INXHINIERËVE
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës
Inženjerska komora Republike Kosova
Chamber of Engineers of The Republic of Kosovo

Në përputhje me nenin 26 të Ligjit Nr.08/L - 012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, nenet 5,7,8,9 dhe 11 të Rregullores për Procedurën e Licencimit, Rilicencimit, Mirëmbajtjen, Pezullimin dhe Revokimin e Licencës së Inxhinierit të Licencuar të Odës me numër protokoli 8651/24 të datës 31.12.2024 dhe bazuar në Vendimin e Komisionit Vlerësues me numër 218/2026 të datës 07.04.2026, Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës, lëshon:

LICENCA A

INXHINIER I LICENCUAR

Siç shihet qartë në fotografinë e mësipërme, fusha e veprimtarisë së kësaj Ode lidhet me fushën e ndërtimit. Kjo vërtetohet edhe nga vetë përmbajtja e licencës, ku shprehimisht përcaktohet se ajo lëshohet për fushën e ndërtimit.



Siç shihet në fotografinë e mësipërme, licencat A dhe B të lëshuara nga Oda e Inxhinierëve të Kosovës për fushën e ndërtimit nuk kanë ndërlidhje me objektin e këtij tenderi, përkatësisht me inspektimin e ashensorëve.



Gjithashtu, edhe në uebfaqen zyrtare të Odës, në përshkrimin e misionit të saj, shihet qartë se veprimtaria e kësaj organizate lidhet me inxhinierët e fushës së ndërtimit dhe aktivitetet profesionale që zhvillohen në kuadër të kësaj fushe.

Inspektimi periodik i ashensorëve në ndërtesat qeveritare, të cilat përfaqësojnë objekte të përfunduara dhe funksionale, ku zhvillohen aktivitete administrative dhe ku qytetarët dhe punonjësit kryejnë aktivitetet e tyre të përditshme, nuk ka asnjë ndërlidhje me fushën e ndërtimit dhe as me licencat e lëshuara nga Oda e Inxhinierëve të Kosovës për këtë fushë.

Rrjedhimisht, konsiderojmë se edhe kjo kërkesë e vendosur nga AK është e pabazuar dhe e kundërligjshme, pasi nuk lidhet me objektin dhe natyrën e shërbimeve që janë objekt i këtij tenderi. Për më tepër, ekzistojnë dyshime të bazuara se ky kriter është përfshirë me qëllim të favorizimit të një operatori ekonomik të caktuar.

Një tjetër element që e përforcon këtë dyshim është fakti se AK ka kërkuar vetëm licencën A dhe nuk ka përfshirë edhe licencën B për të gjithë inxhinierët. Ky përzgjedhim i njëanshëm i kriterit ngre pikëpyetje serioze lidhur me arsyetimin profesional dhe ligjor të kërkesës së vendosur.

Siç kemi theksuar edhe në Pretendimin nr. 5, numri i kompanive në Kosovë që janë të autorizuara dhe të angazhuara në inspektimin e ashensorëve është i kufizuar. Në këtë kontekst, veprimet e AK-së vetëm sa e kanë thelluar dyshimin tonë të bazuar se përmes këtyre ndryshimeve po tentohet të favorizohet një operator ekonomik i caktuar.


Në vend që të sigurojë një procedurë transparente, të drejtë dhe konkurruese, AK e ka shndërruar dosjen e këtij tenderi me vlerë të vogël në një proces të paqartë, kontradiktor dhe jashtëzakonisht voluminoz, duke krijuar një kaos të panevojshëm, madje më të madh se ai që haset në procedurat e tenderëve me vlerë miliona euro.

Theksojmë se të gjitha këto veprime dhe parregullsi i kemi paraqitur edhe pranë Policisë së Kosovës dhe Prokurorisë së Shtetit, me qëllim të trajtimit dhe hetimit të tyre nga institucionet kompetente.

Duke i përmbledhur të gjitha sa u theksuan më lart, ne kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së që këtë pretendim ankimor ta aprovojë si të bazuar dhe ta obligojë Autoritetin Kontraktues që të ndryshojë kërkesat mbi kapacitet teknike dhe profesionale përkatësisht pikën 9.1 dhe 9.2 nënpika 1 (a,b,c) ashtuqë kërkesat për Licencë nga Oda e Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit të hiqet komplet sepse nuk ka të bëjë fare me inspektim të ashensorëve.


Pretendimi9:

Në dosjen e tenderit, përkatësisht në Aneksin 1 Specifikimet Teknike të Detyrueshme, Autoriteti Kontraktues (AK) ka përcaktuar në pikën a) një kërkesë lidhur me pajisjet që duhet t'i posedojë operatori ekonomik, si në vijim:



Fillimisht, theksojmë se kjo kërkesë nuk është e mbështetur në ndonjë bazë ligjore apo profesionale që arsyeton domosdoshmërinë e posedimit të pajisjeve të specifikuara nga Autoriteti Kontraktues. Për më tepër, mënyra se si është formuluar kjo kërkesë, duke mos përcaktuar një listë të plotë dhe të qartë të pajisjeve, por duke e përmbyllur me shprehjen "e të tjera", krijon paqartësi dhe lë hapësirë për interpretim subjektiv dhe trajtim jo të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Ju njoftojmë se përcaktimi i pajisjeve të nevojshme për trupat inspektuese që ushtrojnë veprimtarinë e inspektimit të ashensorëve bëhet nga Drejtoria e Akreditimit të Kosovës (DAK). Kjo drejtori përcakton pajisjet që duhet ti kenë në dispozicion trupat inspektuese, si dhe obligimin për kalibrimin e tyre në baza vjetore. Gjatë vizitave vjetore të mbikëqyrjes nga DAK, verifikohet posedimi i këtyre pajisjeve dhe vlefshmëria e certifikatave përkatëse të kalibrimit. Këto janë ndër kushtet e domosdoshme për lëshimin dhe vazhdimin e vlefshmërisë së akreditimit sipas standardit ISO/IEC 17020.



Kërkesë për Listën e Pajisjeve të Trupave Inspektuese për Inspektimin e Ashensorëve

Inbox ×

Ardiana Shala-Krrabaj
to me, Irfan

2:49 PM (1 hour ago)

I nderuar,

Në lidhje me pyetjet tuaja mbi pajisjet e nevojshme dhe kriteret për trupat inspektuese të ashensorëve, ju njoftojmë si në vijim:

Certifikata e Akreditimit (e shoqëruar me Shtojcën e Akreditimit) dhe Vendimi i Emërimit nga MINTI janë dëshmitë zyrtare se një Trupë Inspektuese është kompetente dhe i plotëson të gjitha kërkesat e standardit ISO/IEC 17020 dhe legjislacionit në fuqi. Procesi i akreditimit dhe mbikëqyrja e rregullt vjetore nga ana e DAK-ut përfshin verifikimin e detajuar të stafit profesional, procedurave teknike, si dhe disponueshmërinë, përshtatshmërinë dhe gjurmueshmërinë metrologjike (kalibrimin) e të gjitha pajisjeve të nevojshme.

Ashtu siç jeni në dijeni, ekipi i vlerësimit gjatë vlerësimit për akreditim kërkon që Trupi Inspektues të ketë pajisjet e nevojshme të kalibruara për inspektimin e ashensorëve, si në vijim: metri shirit, dinamometri matës në shtypje për dyer, dinamometri matës i forcës në litar, tahometër (matës i shpejtësisë), decibelmetër (matës i zhurmës) dhe multimetër (matës i rrymës).

Duke u mbështetur edhe në sqarimin e Departamentit të Industrisë në MINTI, akreditimi sipas ISO/IEC 17020 është kriter themelor për marrjen e emërimit/autorizimit. Si rrjedhojë, në procedurat e prokurimit publik, prezantimi i Certifikatës së Akreditimit (me shtojcën përkatëse) dhe Vendimit të Emërimit nga MINTI përbën dëshmi të mjaftueshme se Trupa Inspektuese i plotëson të gjitha kushtet teknike, profesionale dhe të pajisjeve.

Ndërkohë që hartimi i dosjes së tenderit mbetet në kompetencë të autoriteteve kontraktuese, përcaktimi i kritereve teknike shtesë për stafin apo pajisjet përtej prezantimit të Certifikatës së Akreditimit dhe Vendimit të Emërimit konsiderohet i panevojshëm dhe mund të rezultojë kufizues për konkurrencën e lirë dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë të akredituar.

Me respekt,
Ardiana Krrabaj
Drejtore për Akreditim dhe Zhvillim e DAK

Lidhur me këtë çështje, ne i jemi drejtuar zyrtarisht DAK-ut për të marrë sqarimet përkatëse. Siç dëshmohet edhe nga përgjigjja zyrtare e bashkëngjitur, DAK konfirmon se akreditimi sipas standardit ISO/IEC 17020 garanton që trupa inspektuese i posedon të gjitha pajisjet dhe mjetet e nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë përkatëse të inspektimit.

Rrjedhimisht, duke u bazuar edhe në sqarimin e DAK-ut, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues duhet të kërkojë vetëm certifikatën e akreditimit ISO/IEC 17020, ashtu siç ka vepruar edhe në procedurat e mëparshme të prokurimit, dhe ashtu siç kërkojnë edhe nga DAK në emailin e tyre, dhe jo AK të vendosë kërkesa shtesë për posedimin individual të pajisjeve, të cilat tashmë janë pjesë e procesit të akreditimit dhe verifikohen nga organi kompetent.

Për më tepër, DAK na ka përcjellë edhe listën e pajisjeve të nevojshme për trupat inspektuese, të cilat kërkohen gjatë procesit të akreditimit nga DAK dhe më pas gjatë procesit të emërimit nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINTI). Prandaj, në rast se insistohet në përfshirjen e kërkesave specifike për pajisjet në dosjen e

tenderit, konsiderojmë se këto kërkesa duhet të kufizohen ekskluzivisht në pajisjet e përcaktuara në listën zyrtare të DAK-ut për qëllime të akreditimit sipas standardit ISO/IEC 17020. Bëhet fjalë për të njëjtën listë të pajisjeve që trupa inspektuese e dorëzon edhe pranë MINTI-t në kuadër të procedurës për emërim.

Do të ishte absurde dhe në kundërshtim me logjikën e procesit të akreditimit dhe emërimit që një trupe inspektuese, e cila tashmë është akreditуar nga organi kompetent për inspektimin e ashensorëve dhe ka kaluar me sukses procesin e vlerësimit teknik, ti kërkohet nga Autoriteti Kontraktues posedimi i pajisjeve shtesë, të cilat nuk janë kërkuar dhe nuk janë vlerësuar gjatë procesit të akreditimit nga DAK apo gjatë procesit të emërimit nga MINTI.

Nëse pajisjet e tilla do të ishin të domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë së inspektimit të ashensorëve, ato do të ishin përcaktuar paraprakisht nga ekspertët teknikë vlerësues të DAK-ut gjatë procesit të akreditimit sipas standardit ISO/IEC 17020, si dhe gjatë procesit të emërimit nga MINTI. Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues nuk mund të krijojë kërkesa teknike shtesë, të cilat nuk burojnë nga kërkesat dhe standardet e përcaktuara nga organet kompetente për këtë veprimtari të ndjeshme dhe të rregulluar me dispozita të veçanta ligjore dhe nënligjore, të nxjerra nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI)

Një qasje e tillë jo vetëm që është e panevojshme, por krijon edhe rrezikun e vendosjes së kërkesave disproporcionale dhe kufizuese për operatorët ekonomikë, pa ndonjë arsyetim objektiv apo bazë profesionale që dëshmon domosdoshmërinë e tyre. Për më tepër, formulimi i paqartë i kërkesës, përmes shprehjes "e të tjera", cenon parimin e transparencës dhe sigurisë juridike, pasi operatorët ekonomikë nuk mund të përcaktojnë paraprakisht dhe me saktësi se cilat pajisje shtesë kërkohen nga Autoriteti Kontraktues.

Duke i përmbledhur të gjitha sa u theksuan më lart, ne kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së që këtë pretendim ankimor ta aprovojë si të bazuar dhe ta obligojë Autoritetin Kontraktues që të ndryshojë Aneksi 1 specifikimet teknike te detyrueshme përkatësisht pikën a për pajisjet e kërkuara:

1. Pika "a" e Aneksit 1 të hiqet në tërësi dhe nga OE të kërkohet vetëm Certifikata e Akreditimit ISO 17020 e cila i mbulon pajisjet e nevojshme për inspektim të ashensorëve.

2. Nëse insistohet në kërkim të pajisjeve për inspektim, atëherë të kërkohen pajisjet sipas listës së DAK:

i). Metri Shirit
ii). Dinamometri Matës në Shtypje për Dyer
iii). Dinamometri Matës i Forcës në Litar
iv). Tahometër (matës i shpejtësisë)
v). Decibelmetër (matës i zhurmës)
vi). Multimetër (matës i rrymës)

Përfundim:

Duke i përmbledhur të gjitha pretendimet që u prezantuan më lart, ne kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së që ankesën tonë ta aprovojë si të bazuar dhe ta obligojë Autoritetin Kontraktues që dosja e tenderit të përmirësohet. Në vijim po i listojmë edhe njëherë të gjitha përmirësimet e nevojshme sipas pretendimeve tona:

I) (Pretendimi 3,6) Të obligohet AK të ndryshojë kërkesat mbi kapacitet teknike dhe profesionale përkatësisht pikën 9.1 dhe 9.2 me të gjitha nënpikat duke larguar kërkesat e stafit për inxhinierë. Në këtë mënyrë duke respektuar interpretimin e Ministrisë (MINTI) dhe praktikat e mëparshme të kërkohet vetëm emërimi për inspektim periodik të ashensorëve nga MINTI.

II) (Pretendimi 1,4,5,6) Nëse insistohet për kërkesa të stafit të obligohet AK që të ndryshojë kërkesat mbi kapacitet teknike dhe profesionale përkatësisht pikën 9.1 dhe 9.2 nënpika 1 të Dosjes së Tenderit duke respektuar interpretimin e MINTI dhe rregulloren RKS/MTI 05/2018 dhe duke kërkuar inxhinierë konform këtyre fakteve si në vijim:

Operatori ekonomik ose grup i OE pjesëmarrës duhet të ofroj dëshmi se ka staf të mjaftueshëm, të kualifikuar dhe të verifikuar
nga DAK dhe MINTI për realizimin e kontratës konform legjislacionit në fuqi:
a) Një (1) Inxhinier i Inxhinierisë Mekanike me përvojë pune sipas rregullores RKS/MTI 05/2018.
b) Një (1) Inxhinier i Inxhinierisë Elektronike me përvoje pune sipas rregullores RKS/MTI 05/2018.
c) Njëri nga Inxhinierët e mësipërm duhet të caktohet nga OE si Menaxher i Kontratës.

III) (Pretendimi 2,7) Të obligohet AK që të largojë plotësisht nga Dosja e Tenderit paragrafin e shtuar për Siguri dhe Shëndet në Punë në fund të nënpikës 1, në kuadër të kërkesave për kapacitetin teknik dhe profesional në pikën 9.1 dhe 9.2. Kërkesa për Siguri dhe Shëndet në Punë të definohet si pikë e veçantë e kërkesave për kapacitetin teknik dhe profesional në mënyrë precize si vijon:

Operatori ekonomik ose grup i OE pjesëmarrës duhet të ofroj dëshmi se ka përmbushur kriteret për Siguri dhe Shëndet në Punë konform legjislacionit në fuçi:
a) Të posedojë certifikatën valide ISO 45001 për Siguri dhe Shëndet në Punë.
b) Në rast të mosposedimit të certifikatës ISO 45001 për Siguri dhe Shëndet në Punë, përmbushja e kritereve të dëshmohet përmes dokumenteve në vijim:
i) Certifikata së Trajnimit për Siguri dhe Shëndet në Punë për secilin Inxhinier.
ii) Dokumenti i Vlerësimit të Rrezikshmërisë në vendin e Punës i lëshuar nga personi ose kompania kompetente.

IV) (Pretendimi 8) Të obligohet AK që të ndryshojë kërkesat mbi kapacitet teknike dhe profesionale përkatësisht pikën 9.1 dhe 9.2 nënpika 1 (a,b,c) ashtu që kërkesat për Licencë nga Oda e Inxhinierëve të hiqet komplet sepse nuk ka të bëjë fare me inspektim të ashensorëve por me Fushën e Ndërtimit.

V) (Pretendimi 9) Të obligohet AK që të ndryshojë Aneksi 1 specifikimet teknike te detyrueshme përkatësisht pikën a për pajisjet e kërkuara. Pika "a" e Aneksit 1 të hiqet në tërësi dhe nga OE të kërkohet vetëm Certifikata e Akreditimit ISO 17020 e cila i mbulon

pajisjet e nevojshme për inspektim të ashensorëve.

VI) (Pretendimi 9) Nëse insistohet në kërkim të pajisjeve për inspektim, atëherë të obligohet AK që të kërkohen pajisjet sipas listës së DAK:
i). Metri Shirit.
ii). Dinamometri Matës në Shtypje për Dyer.
iii). Dinamometri Matës i Forcës në Litar.
iv). Tahometër (matës i shpejtësisë).
v). Decibelmetër (matës i zhurmës).
vi). Multimetër (matës i rrymës).

Jemi mirënjohës për kohën dhe përkushtimin e secilit që do ta shqyrtojë këtë ankesë deri në fund.

Si kompani me përvojë mbi 20 vjeçare në fushën e inspektimit të ashensorëve, jemi të përkushtuar ndaj profesionalizmit, integritetit dhe konkurrencës së lirë e të ndershme. Pikërisht në mbrojtje të këtyre vlerave kemi ndërmarrë mundin për përpilimin e kësaj ankese dhe dokumentimin e hollësishëm të shqetësimeve tona, me bindjen se mosreagimi ndaj praktikave të tilla do të krijonte një precedent tejet të dëmshëm për Kosovën dhe të ardhmen e prokurimit publik në vend.

Besojmë në një trajtim të drejtë, të paanshëm dhe në përputhje me ligjin.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Demet e shkaktuara janë shpenzimet ne përgatitjen e ofertës, dëme ne reputacion dhe fitimi i humbur.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*